

# ***RELACION TEKNIK***

**OBJEKTI:** Ndërtim Rrjet Kanalizimi te Ujrave te Zeza në zonën mbi rrugen nr.5,Lagjia nr.3,Sarande.



**SARANDE 2018**

## **1. QËLLIMI**

Qëllimi i realizimit të projektit është ndërtimi i kanalizimeve të ujrave të ndotura për të larguar këto ujra nga blloku i banimit në drejtim të kanalizimit kryesor që është ndërtuar në rrugën nr.5, e cila është rikonstruktuar këtu vit.

Ky projekt do të shërbejë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për banorët në zonën turistike të qytetit Sarandë.

Aktualisht kjo zonë nuk disponon rrjete të kanalizimeve, në kushtet aktuale banorët i kanë realizuar në mënyrë individuale të gjitha shkarkimet e ujrave të përdorura.

Në disa rrugica këtu ujra beheshin presente edhe mbi sipërfaqen e tokës duke shkaktuar rrezik për shëndetin e banorëve sidomos në stinën e verës.

Për këtu arsye është e nevojshme ndërtimi i mirëfilltë i rrjetit të kanalizimeve që do të evidentoj problemin që shkaktohen tek banesat dhe banorët e kësaj zone.

## **2. VËNDODHJA DHE POPULLSIA**

Zona në të cilën do të ndërtohen kanalizimet ndodhet në zonën kadastrale 8642, në pjesën veriperendimore të qytetit mbi rrugën nr.5. Në këtë bllok banimi ndodhen rreth 150 shtëpi me mesatarisht 1000 banorë në sezonin e verës si rezultat i shtimit të turizmit popullsia rritet. Banesat në përgjithësi janë dy deri në tre kate.

## **3. GJËNDJA EKZISTUESE**

Kjo zonë banimi aktualisht nuk disponon rrjet kanalizimesh. Të gjitha shkarkimet e objekteve janë realizuar në mënyrë individuale nga vetë banorët. Ujrat e ndotura të objekteve derdhen në mënyrë të pa organizuar në gropa septike.

Duke qenë se gropat septike janë të ndërtuara nga vetë banorët janë jashtë Kushteve teknike dhe si pasojë ka rredhje uji në sipërfaqe dhe filtrime që ndotin ambientin përreth.

Gropat septike janë të ndërtuara në pozicione ku është e pamundur boshatisja e tyre me mjete, shpesh tejmbushen duke ndotur ambientin.

Pjesësite e terrenit ku kalon tubacioni shkon deri në 25%, për këtu qëllim janë shpeshuar pusët për thyerjen e energjisë.

## **4. RELIEVI TOPOGRAFIK**

Për të hartuar relievin topografik do të vendoset një **Sistem Poligonal Baze** që do të referohet pikave gjeodezike të zonës, duke shënuar trekëndeshat që përcaktojnë

ekzaktesisht kordinatat altimetrike dhe planimetrike. Per kete qellim jane perdorur instrumente topografik te tipit **TOTAL STATION**, duke mare gjithmon parasysh pershkrimet dhe tolerancat e dokumentit baze.

Perdorimi i nje sistemi poligonal te ridizenjimit per korigjimet e nevojshme do te plotesohet me ekzekutimin e matjeve takimetrike ne aks ndermjet **topografise klasike** te strukturave dhe rrugeve qe kryqezohen. Do te punohet per fiksimin e akseve te kanalizimeve dhe marjen e **profilave terthore** te distancuar deri 25m per hartimin e profilave gjatesore.

## **5. ZGJIDHJE TEKNIKE E PROJEKTIT**

Duke patur parasysh te dhenat e kerkesat e detyres se projektimit per projektin eshte menduar zgjidhja e meposhtme:

Ndertimi i rrjetit te kanalizimeve ne zonën mbi rrugen nr.5, Lagjia nr.3, Sarande. konstiston në shtrimin e :

tubo te brinjezuar HDPE SN-8 DN=315 , L =597ml

tubo te brinjezuar HDPE SN-8 DN=250, L =1088ml

tubo te brinjezuar HDPE SN-8 DN=200 ,L =740ml

tubo te brinjezuar HDPE SN-8 DN=160, L =1881ml, per lidhjet nga gropa septike me kanalizimet e reja qe kalojne per ne tubacionin kryesor, sipas piketave te paraqitura ne planimetri.

Dimensionimi i rrjetit eshte pranuar kryesisht konstruktiv me diametra  $\emptyset$ -160mm deri  $\emptyset$ -315mm, ne varesi te numurit te banoreve dhe te funksionit qe kryejn.

Kjo zgjidhje teknike per ndertimin e rrjetit te kanalizimeve realizon shkarkimin e ujrave tezeza ne tubacionin kryesor me diameter 400mm te ndertuar ne rrugen nr.5.

Duke mos qene te sigurte per zhvillimin e zones ne te ardhmen do te perdoret vetem 50% e kapacitetit te plote te tubacioneve te llogaritura. Llogaritjet jane bere per levizjen e lengjeve me renie te lire per dimensionim e rrjetit ne baze te prurjes llogaritese

$Q_{llog} = Q_{specifike}$

kanalizimesh\* Sip  $Q_{sp} =$

$n * p / 86400 = 1,0 \text{ l/s/ha}$

Per  $Q_{kontrolluese} \emptyset 300\text{mm} = 434 \text{ l/s};$

Parametrat Fiziko-mekanike

Pesha vellimore ne gjendje natyrale 1.85-

1.88 t/cm<sup>2</sup> Kendi i ferkimit te brendshem

14-17 grade

Kohezioni 0.27-0.32 kg/cm<sup>2</sup>

Moduli I deformimit 45-65

kg/cm<sup>2</sup> Ngarkesa e lejuar

1.5-1.8 kg/cm<sup>2</sup>.

Zona qe do mbuloje projekti eshte rreth S=10ha.

Kjo zgjidhje teknike eshte e vetmja zgjidhje pasi me ndertimet pa kriter eshte zgjedhur skema me e pershtateshme per largimin e ujrave te zeza. Te kihet kujdes punimet e germimit duhet te kryhen nen vezhgim te vazhdueshen pasi ka intersektime me rrjetin e ujesjellesit dhe te energjise elektrike. Punimet e germimit dhe mbushjes se kanalit per vendosjen e tubave te kyhen ne perputhje me rregullat qe jepen ne KTZ 2-78.

Per realizimin e projekti jane ndjekur hapat e meposhtem:

1. Nga te dhenat topografike jane mare ne teren me TOTAL STATION eshte hartuar relievi i zones ku jane te percaktuara objektet dhe kuotat e terrenit.
2. Jane hequr akset e kanalizimeve ku do te kaloje tubacioni duke mare parasysh te dhenat e mara me pare ne teren nga grupi mbeshtetes .
3. Me keto te dhena duke u mbeshtetur dhe ne kushtet teknike te projektimit jane percaktuar pusetat sekondare dhe kryesore si dhe menyra e funksionimit te largimit te ujrave.
4. Vizatimet jane realizuar ne AUTOCAD CIVIL 3D,sipas detyres se projektimit, i cili mundeson hartimin e profilave dhe llogaritjet e nevojshme.
5. Hartimi i profilave gjatesore eshte bere duke u mbeshtetur ne pikat e mara ne teren.
6. Ne profil jane shenuar piketat,distancat pjesore e progressive,kuotat e tokes dhe te projektit,pjeresite si dhe elementet hidraulik te tubacionit.
7. Profilat jane hartuar ne shkalle vertikale 1:100 dhe horizontale 1:1000.
8. Ne vizatime jane paraqitur vendet e ndertimit te pusetave kryesore dhe sekondare si dhe hollesi te ndertimit te ketyre pusetave si permasat gjeometrike dhe armature e hekurit qe do te perdoret per cdo rast.
9. Pozicioni i vendosjes se pusetave eshte percaktuar duke u mbeshtetur ne KTP dhe ne studimin e degezimeve ne teren.

Ne perfundim skema e kanalizimeve per largimin e ujrave te ndotura ne zonën mbi rrugen nr.5,Lagjia nr.3,Sarande eshte funksionale dhe e qendrueshme ne kohe,ajo realizon largimin e ujrave te ndotura nga gjithe zona.